

VENDIM
Nr. 127, datë 31.5.2022

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ENERGY FINANCING TEAM TIRANA” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa “b”, dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1 germa “e”, neneve 13 dhe 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.5.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 830/2 prot., datë 27.5.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Energy Financing Team Tirana’ sh.p.k., me nr. 377, seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 27.7.2017,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 67, datë 11.4.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën nr. 70/7 prot., datë 13.4.2022, bëri njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 28.4.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike.

- Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka përcjellë dokumentacionin e aplikimit, si vijon:

- Formatin dhe dokumentacionin për aplikim – neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”;
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor – neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”;
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal – neni 9, pika 3, germat “b”, “c”, “d”;
- Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike – neni 9, pika 4.8, germat “a”, “b”, “c”.

Në lidhje me mungesën e konstatuar në dokumentacionin financiar dhe fiskal – neni 9, pika 3:

- Germa “a” (vërtetim për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore); vlerësohet t’i lihet shoqërisë kusht në vendim që të informojë ERE-n çdo tre muaj, në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor, deri në dokumentimin e një vërtetimi të pastër tatimor.

- Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 377, seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, që nga data 27.7.2017, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 119 me afat vlefshmërie deri në datën 27.7.2022.

- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Sikurse konstatohet shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj në datën 10.2.2022, gati 5 (pesë muaj) përpara përfundimit të afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1, të rregullores, ndaj, si e tillë vlerësohet që më poshtë në dispozitiv të specifikohet data e fillimit të vlefshmërisë së saj, duke filluar nga data 28.7.2022.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike bazuar në aneksin A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Shoqëria “*Energy Financing Team Tirana*” sh.p.k. ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 377, seria T17, të shoqërisë “*Energy Financing Team Tirana*” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 27.7.2017, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 28.7.2022.

2. Shoqëria “*Energy Financing Team Tirana*” sh.p.k. të informojë ERE-n çdo tre muaj, në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor, deri në dokumentimin e një vërtetimi të pastër tatimor.

3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti